



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 15.5.2023

Nr: 72

Ora: 12:30

U R D H Ë R

PËR

ORGANIZMIN E GRUPEVE TË NUMËRIMIT TË VOTAVE NË VNV, PËR VAZHDIMIN NË MËNYRË TË PANDËRPRERË TË PROCESIT, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023

Në mbështetje të pikës 1, shkronja “b”, dhe pikës 2, të nenit 19, e neneve 32, pika 1, shkronja a dhe pika 3, 33 shkronja a dhe ë, neni 119 pika 5, neni 168 dhe 171 pika 5, të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 23, datë 24.4.2023 “Për organizimin e punës në Vendin e Numërimit të Votave, radhën e veprimeve gjatë dorëzimit të materialeve zgjedhore, numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit të zgjedhjeve për zonën e administrimit zgjedhor, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore”,

URDHËROJ:

1. KZAZ-të në bashkëpunim me përfaqësuesit e partive politike që kanë të drejtën e propozimit për anëtarë të grupeve të numërimit të votave, të përcaktojnë paraprakisht listat e numëruesve që, sipas rastit, do të zëvendësojnë ata që largohen, tërhiqen, apo kanë qëndruar në detyrë me orar të zgjatur.
2. KZAZ-ja, me përjashtim të rasteve të marrjes së vendimeve, mund të organizojë praninë e anëtarëve të saj në ambientet e VNV-ve mbi bazë të një sistemi rotacioni.
3. Ngarkohen KZAZ-të për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 15.5.2023 Nr. 72
Ora: 12:30



“Për organizimin e grupeve të numërimit të votave në VNV, për vazhdimin në mënyrë të pandërprerë të procesit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

Data: 2023 Nr.
Ora: 12:00



“Për disiplinimin dhe vazhdimin në mënyrë të pandërprerë të procesit të numërimit të të gjitha kutive të votimit të pranuar të rregullta nga KZAZ-të”